



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 629/8 prot.

Elbasan, me 06.03.2021

**VENDIM**

Nr. 14 datë 06.03.2021

**Për**

**skualifikim nga përjashtimi nga tarifa vjetore e shkollimit dhe përfitim ulje tarife të studentëve të ndarë nga trangu familjar**

Në mbështetje të nenit 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", e ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit," e ndryshuar, VKM-së Nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, Bordi i Administrimit në mbledhjen Tij të datës 06.03.2021,

**VENDOSI:**

- 1- Të mos përfshihen në skemën e përfitimit nga tarifa vjetore e shkollimit studentët e Ciklit të parë për program të parë studimi që figurojnë të ndarë nga trangu familjar (prindërit e tyre nuk janë të ndarë nga jeta).
- 2- Të mos përfshihen në skemën e përfitimit ulje nga tarifa vjetore e shkollimit studentët e Ciklit të dytë për program të parë studimi që figurojnë të ndarë nga trangu familjar (prindërit e tyre nuk janë të ndarë nga jeta).
- 3- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT**  
**ARDIAN DURMISHI**